

12- Insulina (pjesa e parë)

Insulina është një hormon që prodhohet nga qelizat beta të pankreasit dhe shërben për të vënë në përdorim glukozën e gjakut, duke mundësuar hyrjen e saj në qelizat që e përdorin për të prodhuar energji. Insulina është “çelësi” që i hap portën e qelizave sheqerit dhe ul për rrjedhojë nivelet e tij në gjak.

Si merret insulina



Kur pankreasi nuk prodhon më insulinë ose nuk prodhon mjaftueshëm, nevojitet furnizimi me të nga jashtë me anë të një injeksioni në indin subkutan.



Insulina nuk mund të merret nga goja, por mund të injektohet vetëm nën lëkurë, me anë të një shiringe të veçantë ose me një penë me agje.




Mjeku përshkruan llojin e insulinës, dozat dhe skemën e marrjes së saj, pra, sa njësi të injektojmë dhe kur duhet t'i injektojmë (në vakte ose para se të shkojmë në shtrat).

Si të përdorim një penë insuline



Pena përbëhet nga një agje një përdorimëshme, nga një fishek i mbushur paraprakisht me insulinë dhe nga një fushë ku zgjidhen njësitë për injektim duke rrotulluar unazën.




Insulinat e para përziera (30/70, 50/50, 70/30) duhet të rrotullohen disa herë, në mënyrë që të tunden butësisht, përpara se të merren.



Përpara çdo injeksioni, kontrolloni funksionimin e penës dhe të agjes duke lejuar të dalin jashtë disa njësi për provë. Pas injeksionit numëroni deri në 10 përpara se të nxirrni agjen nga lëkura.

Mbani parasysh që...



Pena në përdorim ruhet në temperaturë mjedisi. Penat e tjera mbahen në frigorifer në katin më të ulët (jo në ngrirës).



Insulina e ekspozuar në temperatura ekstreme mund të humbasë pjesërisht efektshmërinë e saj. Një çantë e vogël termike është ideale për ata që udhetojnë ose lëvizin për në punë.



Pasi keni kryer injeksionin e insulinës, mos e shmangni ose shtyni vaktin pasi mund të rrezikohet hipoglicemia.